



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 12938 Prot

Shkodër, më 27.07.2021

**Lënda: Informacion mbi procesin e zhvendosjes së “Shkodra Tourist Official Brand & Shop”**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

Lidhur me kërkesën për informacion të Këshillit Bashkiak mbi procesin e zhvendosjes së “Shkodra Tourist Official Brand & Shop” në një pozicion më të përshtatshëm ju informojmë se Bashkia Shkodër ka vijuar me hartimin dhe firmosjen marrëveshjes së lejes për zhvendosjen e “Shkodra Tourist Official Brand & Shop”. Gjatë ditëve të fundit është realizuar zhvendosja e të gjitha mterialeve dhe pajisjeve, proces i cili do të përfundojë gjatë ditës së nesërme.

Bashkia Shkodër ka siguruar qendrshmërinë në zbatimin e projektit Shkodra Tourist Official Brand, i cili ka për qëllim të kontribuojë në forcimin e identitetit turistik të Bashkisë Shkodër, nëpërmjet promovimit të *Markës Zyrtare të Shkodrës*, të përshtatur në një shumëllojshmëri produktesh/suvenire turistike inovative, të ideuara dhe prodhuara në territor me përfshirjen e aktorëve lokale dhe artizanëve, për të sjellë një risi në treg, me synim:

- Promovimin e turizmit në Shkodër nëpërmjet markës “Shkodra tourist official brand”.
- Promovimin e produktit “souvenir” si një simbol identifikues të territorit të origjinës.
- Rritjen e kapaciteteve të artizanëve dhe të rinjve në Shkodër për dizenjimin dhe prodhimin e suvenireve.

Ky aktivitet realizhet në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligjit nr.93/2015, “Për Turizmin” i ndryshuar; Ligjit nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar; Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM nr.1706, datë 29.12.2008, “Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Markave Tregtare dhe të Shërbimit”; VKM Nr.883, date 13.5.2009 “Për Miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, i ndryshuar me VKM nr.316, datë 31.05.2018; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar; VKB nr. 69, datë 30.10.2017 “Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Bashkisë Shkodër dhe Metodologjisë LOD”; Marrëveshjes Financiare datë 09.08.2018, e lidhur ndërmjet UNDP dhe Mandarina Project me përfitues Bashkinë Shkodër për zbatimin e projektit “Shkodra Tourist Official Brand & Shop”;

---

Strategjia territoriale e Bashkisë Shkodër 2015 – 2030; Marrëveshje bashkëpunimi nr. 476,  
datë 10.01.2020 ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Mandarin Project;

**KRYETAR**  
**(VOLIANA ADEMI)**

A circular blue ink stamp from the Municipality of Shkodër, Republic of Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE-SË" at the top and "BASHKIA SHKODËR" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.